



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

	FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
Nr. Ref.	615/12
Data	30.04.2024
Nënshkrimi	Jadri
	Prishtinë

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i shkallës së parë në përbërje prej: Metë Çeku – kryetar, Avni Shala dhe Donat Lushaku – anëtarë, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2024 shqyrtoi procedurën e hapur disiplinore nga mbledhja e kaluar e datës 16.04.2024, ndaj z. Jeton Gashi, kryetar i KF Ulpiana 1926 nga Lipjani, për dyshimin e kurdisjeve të ndeshjeve, akuza të pabazuara drejtuar organeve të FFK-së, si dhe shpifje e mashtrim në deklaratat e tij të dhëna në emisione televizive, duke u mbështetur në nenin 63, paragrafi 1, dhe paragrafi 4, të Statutit të FFK-së, si dhe nenit 8, paragrafi 2, pika g), nenit 25, neni 60, paragrafi 2, pika 2, nenit 91, të Rregullores Disiplinore të FFK-së, dhe neni 8, paragrafët 1 dhe 8 të Kodit të Etikës së FFK-së, merr këtë:

V E N D I M

I. z. Jeton Gashi, kryetar i KF Ulpiana 1926 nga Lipjani me numër të ID-së 01144M77, për kurdisje të ndeshjeve, dhe akuzave drejtuar ndaj organeve të FFK-së, si dhe shpifje dhe mashtrim të opinionit i shqiptohet masa disiplinore **“Përfshirje nga organizata e futbollit”**.

A r s y e t i m

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës me datë 30 prill 2024 ka mbajtur mbledhjen e radhës lidhur me procedurën disiplinore të iniciuar ndaj z. Jeton Gashi, kryetar i klubit KF Ulpiana 1926, lidhur me dyshimin se kundërvajtjet e kryera nga i njëjti, me pasoja posaçërisht të rënda të mbarëvajtjes e integritetit të garave në futbollin e Kosovës. Dyshimet për kurdisje të z. Jeton Gashi janë evidentuar që në ndeshjen e zhvilluar me datë 07 prill 2024 në mes të KF Ulpiana 1926 dhe KF Vllaznia, ashtu si evidentohet në raportin zyrtar të delegatit, incizimet televizive, deklaratat konfidenciale, mesazhet telefonike, vendimi i datës 12.04.2024 i Komisionit Disiplinor dhe provat tjera.

Po ashtu z. Jeton Gashi është i dyshuar për përfshirje edhe në raste të tjera të KF “Ulpiana 1926” me klube tjera, që lidhen me marrëveshje për kurdisje të rezultateve, kësisoji duke kryer një sërë të kundërvajtjeve. Se z. Jeton Gashi ka qenë i përfshirë në veprimtari të tilla edhe më parë, dëshmohet edhe nga ish-nënkryetari i KF Ulpiana 1926, z. Liridon Kozhani në një intervistë televizive të dhënë me datën 21.04.2024, ku ai deklaroi se *“z. Jeton Gashi ka tentuar të kurdisë ndeshjen Ulpiana – Ferizaj për një shumë prej 15,000 euro, por ai dhe lojtarët e tjerë nuk kanë pranuar të marrin pjesë në këto veprime. Ndeshja u humb në mënyrë tjetër në tavolinë me rezultat zyrtar 3:0 në favor të Ferizajt”*. Për të mos u mjaftuar me kaq dhe e një rëndësie të veçantë është edhe deklarata e njërit nga futbollistët, identiteti i të cilit mbetet konfidencial, në emisionin televiziv sportiv ‘Kampionët’ në Televizionin Kanal 10, më datë 14.04.2024, ku ka deklaruar edhe lidhur me një ndeshje tjetër të zhvilluar nga KF Ulpiana 1926 *“se është dashtë me e lëshu lojën sipas marrëveshjes së dy kryesive”*, duke vazhduar tutje duke thënë se *“nuk pranuan të vazhdojmë lojën e të paguhet njersa jonë sic kanë mendu ata”*, dhe shumë të tjera e të cilat janë të evidentuara në incizimet televizive të emisionit në fjalë dhe provat tjera për të cilat organet ligjzbatuese janë duke e trajtuar rastin.



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

z. Jeton Gashi ka marrë pjesë në emisionin televiziv sportiv “Favorit” të Televizionit T7 të datës 14.04.2024, dhe në emisionin sportiv ‘Dueli Sportiv’, gjatë të cilave i njëjti ka akuzuar dhe shpifur pa bazë ndaj strukturave udhëheqëse të FFK-së dhe arbitrit të ndeshjes, duke tentuar të denigrojë figurën e FFK-së, me shpifje dhe mashtrim të opinionit publik për të evituar parregullsit dhe kurdisjet që i viheshin në barrë.

Në nenin 25, të Rregullores Disiplinore të FFK-së parashihet se *“Person i dënuar me këtë lloj dënimi, fshihet nga anëtarësia e organizatës së futbollit dhe nuk mund të kryejë kurrfarë funksioni në sportin e futbollit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të FFK-së.”* Tutje, në nenin 29 të Rregullores Disiplinore përcaktohet se *“Si raste të rënda të kundërvajtjeve disiplinore, për të cilat organet disiplinore mund t’i shqiptojnë kryerësit dënimin më të rëndë, konsiderohen ato kundërvajtje, gjatë kryerjes së të cilave, kryerësi ka vepruar me vendosmëri, këmbëngulësi dhe paarsyeshmëri të posaçme ose kur kundërvajtja ka shkaktuar pasoja posaçërisht të rënda ose është kryer nën rrethana posaçërisht të rënda.”* Ndërsa në nenin 60, paragrafi 2, pika 2 përcaktohet qartazi se *“g) Ndërsa në raste të rënda dhe të përsëritura dënohen: - stafi profesional (trajnerët), zyrtarët e klubit, zyrtarët e ndeshjes, gjyqtari ose pjesëmarrësi tjetër në ndeshje ose gara, me ndalesë së kryerjes së funksionit, referimit ose përjashtim nga organizata e futbollit.* Me rastin e përcaktimit të masës disiplinore ndaj z. Gashi, Komisioni është mbështetur dhe në nenin 8, paragrafi 1 të Kodit të Etikës së FFK-së ku theksohet se *“Kur shqipton masë, Komisioni Disiplinor dhe i Etikës do të merr parasysh të gjithë faktorët relevant të rastit, përfshirë natyrën e shkeljes; interesin substancial në pengim të shkeljes; bashkëpunimin e kryerësit të shkeljes me Komisionin Disiplinor dhe të Etikës; **motivin; rrethanat; shkallën e përgjegjësisë dhe shkallën në të cilën kryerësi i shkeljes pranon fajin**”,* dhe paragrafi 8 i të njëjtit nen përcakton këtë *“Përsëritja e shkeljes/ve do konsiderohet **masë rënduese**”.*

Të bazuar në dispozitat përkatëse të Rregullores Disiplinore të FFK-së, vendimi për përjashtimin e zotit Jeton Gashi është i drejtë dhe i justifikuar. Veprimet e tij janë të papranueshme, përsëritëse dhe dëmtojnë rëndë integritetin dhe imazhin e futbollit. Në përputhje me kriteret për raste të rënda të kundërvajtjeve disiplinore, veprimet e tij kanë shkaktuar pasoja posaçërisht të rënda dhe ka vepruar me këmbëngulësi dhe paarsyeshmëri të posaçme. Prandaj, përjashtimi nga organizata e futbollit është një masë e përshtatshme dhe e nevojshme për të ruajtur integritetin dhe reputacionin e futbollit dhe mbarëvajtjen e rregullt të garave të futbollit të orgnizuar në Republikën e Kosovës.

Andaj bazuar në këto gjendjen faktike të lartcekura, dhe provat materiale me të cilat disponon Komisioni Disiplinor dhe i Etikës u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

Prishtinë, 30.04.2024

Komisioni- Disiplinor dhe i Etikës – shkalla e parë

Kryetar: Metë Çeku

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afatin kohor prej 8 (tetë) ditësh, nga data e publikimit të vendimit në web faqen zyrtare të FFK-së, përmes këtij Komisioni, tek Komisioni i Ankesave. *Ankesa e ushtruar ndaj këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit .*